




INSTITUTI KOMBËTAR I SHËNDETËSISË
PUBLIKE TË KOSOVËS
NATIONAL INSTITUTE OF PUBLIC HEALTH
OF KOSOVA



SITUATA EPIDEMIOLOGJIKE ME INFLUENCË SEZONALE DHE
PATOGENËT TJERË RESPIRATORË NË KOSOVË,
SEZONA 2024/2025 (JAVA 48-TË)

Simptomet e Gripit përfshijnë:

- Temperaturë/ethe
- Kokëdhimbje
- Lodhje
- Kollë e thatë
- Dhimbje fyti
- Rrjedhje hundësh
- Dhimbje muskulare
- Simptome gastrointestinale, si nauze dhe barkqitje




PËRMBLEDHJE

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike gjatë tërë vitit bën mbikëqyrjen permanente të Influcencës sezonale (ILI), ARI dhe SARI me intensifikim të aktiviteteve gjatë sezonës përkatëse. Mbikëqyrja realizohet përmes hulumtimit aktiv dhe pasiv në institucione shëndetësore dhe terren.

SITUATA EPIDEMIOLOGJIKE ME INFLUENCËN SEZONALE NË KOSOVË, 2020/2021 -
2024/2025

Sipas grafikonit 1, ku janë paraqitur rastet e Influcencës sezonale (ILI) në 5 sezonat e fundit shohim se sezona 2024/2025 karakterizohet me numër më të ulët të rasteve të raportura, krahasuar me periudhën e njejtë të sezonës 2023/2024 dhe fillim të aktivitetit të Influcencës A nga java e 40-të, 2024/2025 (Graf.1).

Grafikoni.1




SITUATA EPIDEMIOLOGJIKE ME INFLUENCËN SEZONALE NË KOSOVË, 2024/2025 DHE PRAGU EPIDEMIK

Nga fillimi i sezonës, 30 shtator 2024 deri më 1 dhjetor 2024 (java e 48-të) në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës janë raportuar 19,185 raste të Sëmundjes të ngjashme me Grip (ILI), 3,323 raste të Infeksioneve respiratore akute (ARI) dhe 43 raste me Infeksion të rëndë respirator akut (SARI).

Gjatë javës së 48-të (25.11.2024-01.12.2024) janë raportuar 2,266 raste ILI (Sëmundje e Ngjashme me Gripin), 350 raste ARI (Infeksion Respirator Akut) dhe 7 raste me SARI (Infeksion i Rëndë Akut Respirator).


Intensiteti i Influencës sezonale sipas numrit të rasteve të raportuara për javën e 48-të paraqitet në aktivitetin e mesëm të qarkullimit dhe krahasuar me javën paraprake shënon një rritje minimale prej 0.75%. (Graf.2)


Grafikoni.2



Në grafikoni 3 shohim se në të gjitha komunat janë raportuar raste të dyshimta në Grip dhe sipas numrit të rasteve të raportuara, numër më të lartë kanë komuna e Prishtinës, Prizrenit, Ferizajit dhe Pejës ndërsa sipas incidencës numër më të lartë të rasteve kanë komuna e Prishtinës, Kamenicës, Hanit të Elezit, Obiliqit, Mitrovicës, Gjilanit dhe Pejës. (Graf.3).


Grafikoni.3





Në raport me distribuimin e rasteve sipas grup-moshës dhe incidencës, nga numri total i rasteve të raportuara me ILI, shihet se të gjitha grup-moshat janë të atakuara mirëpo vërehet një numër më i madh i rasteve të grup-mosha 15-64 vjeç (Graph.4). Sa i përket rasteve me ARI, grup-mosha më e atakuar është 0-4 vjeç (1,592 raste) pastaj grup-mosha 15-64 vjeç (922 raste), 5-14 vjeç (561 raste) dhe grup-mosha 65+ vjeç (248 raste). (Graf.4)

Grafikoni.4



MBIKËQYRJA VIROLOGJIKE

Në laboratorin e Qendrës Kombëtare të Influcencës – IKSHPK nga fillimi i sezonës 2024/2025 deri me 1 dhjetor 2024, janë testuar gjithsej 875 mostra nga pacientët e qendrave sentinel dhe jo sentinel si raste të dyshimta në ILI, ARI dhe SARI. Nga mostrat e testuara 439 (50.17%) prej tyre të dyshimta në SARS-CoV-2 dhe 436 (49.82%) të dyshimta në Influcencë dhe patogjenët tjerë respiratorë.


Gjatë kësaj periudhe në SARS-CoV-2 janë konfirmuar 6 prej tyre (1.59%).

Nga 436 mostrat e testuara në Influcencë dhe patogjenët tjerë respiratorë janë konfirmuar 14 raste me Influcencë A dhe B (pozitiviteti 3.21%). Sipas tipit: me Influcencë A (12 raste apo 2.75%) dhe Influcencë B (2 raste apo 0.45%), sipas komunave: komuna e Prishtinës (9 raste), Lipjanit (2 raste) dhe me nga një rast komunat: Vushtrri, Pejë dhe Podujevë, sipas grup-moshës 5-14 vjeç (10 raste), 0-4 vjeç (2 raste) dhe 35-50 (2 raste). Rastet e konfirmuara me Influcencë A dhe B nuk janë të vaksinuara me vaksinën kundër gripit sezonal.

Nga patogjenët tjerë respiratorë, janë konfirmuar: 50 mostra me Human Rhinovirus, 31 mostra me RSV, 29 mostra me Human Adenovirus, 5 mostra me Parainfluenza Virus dhe 1 mostër me Metapneumovirus.


Nga 31 rastet pozitive në RSV: 28 prej tyre i takojnë grup-moshës 0-4 vjeç dhe 3 raste i takojnë grup-moshës 5-14 vjeç kurse sipas komunave: Prishtinë (18 raste), Podujevë (5 raste), Fushë Kosovë (2 raste), Mitrovicë (2 raste) dhe me nga 1 rast komunat : Ferizaj, Gjilan, Lipjan dhe Obiliq.

Grafikoni.5



Sipas subtipit me Influencë A të pasubtipizuar (9 raste), me subtipin AH3 (3 raste), Influencë B Victoria (1rast) dhe Influencë B të pasubtipizuar (1 rast).

Grafikoni.6



AKTIVITETET SEZONALE

IKSHPK/Departamenti i Epidemiologjisë bënë mbikëqyrjen e Influcencës gjatë tërë vitit, me intensifikim të saj gjatë sezonës përkatëse (java e 40 deri në javën e 20),

Përcjell situatën epidemiologjike me rastet ILI/ARI (javore) dhe rastet me SARI (në bazë ditore/alerti).

Bënë testimin laboratorik të mostrave në Departamentin e Mikrobiologjisë/Qendrën Kombëtare për Testimin e Influcencës.

Instituti Kombëtar ka apeluar te të gjithë Drejtorët Rajonal të Shëndetësisë Publike dhe punëtorët shëndetësor që të ngrisin nivelin e vigjilencës dhe raportimit të rasteve të dyshimta në të gjitha institucionet shëndetësore publike dhe private në Kosovë.

Ka rekomanduar tek Inspektorati shëndetësor dhe sanitar të mbikëqyrë të gjitha Institucionet shëndetësore të Kosovës, për të urdhëruar për obligimin ligjor të paraqitjes së sëmundjeve ngjitëse dhe rasteve të vdekjeve nga këto sëmundje.

Ka dhënë këshilla për popullatën për mbrojtjen nga sëmundja dhe njohjen e simptomeve të saj.

MASAT PËR PARANDALIMIN E PËRHAPJES SË VIRUSIT TË GRIPIT SEZONAL

Aktiviteti i gripit është në nivel mesatar krahasuar me sezonën paraprake dhe masat për parandalimin dhe kontrollin e infeksioneve respiratore janë:

Mbajtja e maskave.

Distanca fizike.

Higjiena e duarve.

Evitimi i kontakteve të afërta me individë të sëmurë.

Redukimi i vizitave të familjarëve tek personat e hospitalizuar (SHSKUK, Spitalet rajonale).

Evitimi i vendeve të mbyllura dhe të mbingarkuara me njerëz.

Ushqimi i shëndetshëm me shumë vitamina.

Aktiviteti fizik dhe gjumë i mjaftueshëm.

Personat e sëmurë të qëndrojnë në shtëpi.

- Pastrimi dhe dezinfektimi i mjediseve ku qëndroni.
- Mbulimi i hundës dhe gojës me një shami gjatë teshtitjes dhe kollitjes si dhe hudhja më pas në vend të sigurt.
- Larja e duarve shpesh me ujë dhe sapun, ose solucione duarsh me alkool.
- Sytë, hunda dhe goja të mos preket me duar të kontaminuar, pasi virusi përhapet në këtë mënyrë.
- Pastrimi dhe dezinfektimi i sipërfaqeve dhe objekteve që mund të jenë kontaminuar nga virusi.

Konsultimi me mjekun për mjekimin me barna kundër gripit, të cilat duhet të merren vetëm me rekomandimin e mjekut

Medikamentet kundër gripit duhet të fillohen brenda 48 orëve të para të fillimit të sëmundjes për të pasur efektivitet të lartë.

Ato mund të parandalojnë edhe komplikimet e rënda që mund të vijnë nga gripit.

Mënyra më efikase për parandalimin e virusit të gripit është Vaksinimi me vaksinën kundër gripit.

- Vaksinimi mbron vetë personin dhe ndihmon në parandalimin e përhapjes së gripit.
- Vaksinimi kundër gripit sezonal bëhet në muajt tetor–dhjetor.
- Efekti i vaksinës fillon 1 deri 2 javë pas marrjes dhe mbrojtja vazhdon rreth një vit pas vaksinimit.

VAKSINIMI

Ministria e Shëndetësisë në bashkëpunim me IKSHPK në fillim të sezonës së gripit 2024/2025 ka siguruar 85,000 doza të vaksinës sezonale. Nga 30 shtatori deri me 30 nëntor janë administruar 61,467 doza. Prej tyre sipas grupeve të rrezikut: 41,420 janë administruar te grup-mosha mbi 65 vjeç, 18,425 me sëmundje kronike, 1,598 profesionistë shëndetësor, 3 gra shtatzëna dhe 21 fëmijë (0-5 vjeç).

HOSPITALIZIMET

Gjatë javës së fundit nga rastet e hospitalizuara në Klinikën Infektive, Klinikën e Pediatriisë dhe spitalet rajonale janë raportuar 41 raste me ARI, 2 raste me ILI dhe 7 raste me SARI.

SITUATA EPIDEMIOLOGJIKE NË RAJON DHE EVROPË

INFLUENCA SEZONALE JAVA 48/2024 NË EVROPË

Aktiviteti i sëmundjeve akute respiratore (ARI) ka pësuar rritje të lehtë, me nivele të larta në kujdesit primar në disa shtete, me katër vende që raportojnë aktivitet të ulët dhe një vend që raporton aktivitet të mesëm të qarkullimit. Infeksionet respiratore dhe gripit mbeten në nivele të krahasueshme me sezonin e kaluar.

Aktiviteti për sëmundjet e ngjashme me gripin (ILI) dhe infeksionet akute të rënda të frymëmarrjes (SARI) kanë mbetur të qëndrueshme. Aktiviteti i SARS-CoV-2 ka pësuar një rënie, me nivele pozitiviteti më të ulëta krahasuar me vitin 2023. Situata mbetet e ndryshme në nivel të shteteve raportuese, me individët mbi 65 vjeç më të prekur nga sëmundjet e rënda të COVID-19.

Aktiviteti i gripit sezonal mbetet në nivele të ulëta në shumicën e shteteve të BE/ZEE, por tre shtete përëndimore kanë raportuar një rritje të aktivitetit të gripit, veçanërisht në kujdesin primar dhe sekondar ndërsa aktiviteti i RSV-së është rritur ndjeshëm, duke shënuar fillimin e valës epidemike sezonale. Megjithëse fëmijët shumë të vegjël janë zakonisht grupmosha më e prekur, individët 65 vjeç e lart janë gjithashtu në rrezik dhe mund të zhvillojnë forma të rënda të sëmundjes. Disa shtete ofrojnë gjithashtu vakcina kundër RSV-së për gratë shtatzëna dhe të moshuarit, si dhe imunizim me antitropa monoklonale për foshnjat.

Nga viruset e gripit të zbuluara gjatë javës 46 në rajon, viruset e tipit A (85%) ishin më të shumtë krahasuar me viruset e tipit B (15%). Në javën aktuale, viruset e tipave A dhe B po qarkullojnë në të gjitha vendet që raportojnë raste pozitive të gripit.

OBSH rekomandon që vaksinat trivalente të përdoren gjatë sezonit 2024-2025 të gripit në hemisfera veriore përmban një A/Victoria/4897/2022 ose A/Ëisconsin/67/2022 (H1N1) pdm09-si virusi (nënkladi 5a.2a.1); një virus i ngjashëm me A/Tailand/8/2022 ose A/Massachusetts/18/2022 (H3N2) (kladi 2a.3a.1 (J)); dhe një virus i ngjashëm me B/Austria/1359417/2021 (B/Victoria lineage).

Burimi: https://www.ecdc.europa.eu/sites/default/files/documents/communicable-disease-threats-report-week-48-2024_2-December.pdf